



Instituti Demokratik i Kosovës  
Kosova Democratic Institute  
[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

## Zyrat e deputetëve

Mundësi për përfaqësim më të mirë të qytetarëve

## Constituency Offices

Opportunity to Better Represent Citizens



Prishtinë, Qershor / June 2010

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht paraqesin edhe qëndrimet e donatorëve.

The views expressed in the paper do not necessarily represent the views of the donors.

### PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*

Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*

Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*

Arsim GJINOVCI - *IT & design*

### PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Valmir ISMAILI - *Menaxher programi*

Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*

Isuf ZEJNA - *Monitorues*

Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*

Liridon SELMANI - *Monitorues*

### PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - *Koordinator*

Ramadan KLISURICA - *Koordinator*

### PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*

Esat MAZREKU - *Koordinator*

## Përmbajtja

1.	Hyrje.....	5
2.	Rëndësia e komunikimit dy-kahor.....	6
3.	Iniciativat e gjertanishme për hapjen e zyrave për deputetë.....	7
	Sistemi zgjedhor pengesë për avancim të komunikimit dy-kahor.....	9
	Si do të duhej të funksiononin zyrat për deputetë.....	11
	Komunikimi zgjedhës- të zgjedhur.....	11
A.	Masat.....	12
	Masa 1.....	12
	Masa 2.....	12
	Masa 3.....	12
	Përshkrimi.....	12
	Masa 4.....	13
	Përshkrimi.....	13
	Masa 5.....	13
	Përshkrimi.....	13

## 1. Hyrje

Krahas funksionit të nxjerrjes së ligjeve dhe mbikëqyrjes së degës së Ekzekutivit, përfaqësimi i qytetarëve është një tjetër funksion kryesor i Kuvendit. Pikërisht, funksioni i përfaqësimit në Kuvendin të Kosovës, përkatësisht komunikimi dy-kahor në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve është çështje trajtimi e këtij punimi diskutues.

Është më se e qartë se deri më tani nuk ka pasur një komunikim të mirëfilltë në mes të deputetëve dhe zgjedhësve të tyre. Në fakt deri më tani kanë ekzistuar disa iniciativa ad hoc të organizatave të ndryshme që e mbështesin punën e Kuvendit dhe të OJQ-ve lokale, si dhe disa iniciativa vetanake të disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës, mirëpo asnjëherë nuk ka pasur një nismë institucionale dhe të përhershme në këtë drejtim. Ndër arsyet kryesore të mungesës së komunikimit deputetë-zgjedhës konsiderohen sistemi zgjedhor aktual në Kosovë si dhe mungesa e kushteve të duhura të deputetëve për të komunikuar me qytetarë. Megjithatë, mungesa e vullnetit politik të deputetëve për të komunikuar me qytetarë është një arsye tjetër pse aktualisht nuk ka një marrëdhënie të shëndoshë në mes të deputetëve dhe zgjedhësve.

Një seri e tryezave të organizuara nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në komuna të ndryshme të Kosovës në lidhje me punën e deputetëve të Kosovës në legjislaturën e tretë, vetëm sa kanë konfirmuar mungesën e komunikimit ndërmjet deputetëve dhe qytetarëve, sikurse edhe mungesën e komunikimit në mes të institucioneve lokale dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Megjithatë në të gjitha këto tryeza si konkluzion i përgjithshëm ka qenë që komunikimi në mes të deputetëve, qytetarëve dhe organeve të pushtetit lokal është më se i domosdoshëm dhe se ky komunikim duhet përmirësuar, sikurse edhe është shprehur një gatishmëri e palëve të përfshira që të bëhet diçka më shumë në këtë drejtim.

Duke marrë për bazë përfundimet e tryezave të lartpërmendura, KDI ka marrë këtë iniciativë që hartoj një punim diskutues i cili do t'i ofronte deputetëve të Kuvendit të Kosovës një alternativë se si të përmirësonin komunikimin e tyre me qytetarë.

“Në një  
demokraci, sa më  
shumë njerëz të  
përfshihen aq  
më shumë rezul-  
tate do të ketë”

(Koch 1997).

## 2. Rëndësia e komunikimit dy-kahor

Zyrat për deputetë kanë një rëndësi të veçantë në plotësimin e relacioneve të komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe deputetëve me qëllim që përfaqësimi i interesave të qytetarëve në organin e tyre përfaqësues të jetë sa më dobiprurës. Përmes zyrave të deputetëve realizohet roli përfaqësues i deputetit ku ai bëhet urë lidhëse në mes të qytetarëve dhe institucioneve qendrore të shtetit.

Zyrat për deputetë duhet të synojnë avancimin e komunikimit mes deputetëve dhe elektoratit me qëllim të rritjes së nivelit të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së publikut në jetën politike të vendit, duke tentuar që të forcojë nivelin e demokracisë dhe zhvillimin e institucionit të Parlamentit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek institucionet, veçanërisht në institucionin e Kuvendit.

Qëllimi i zyrave për deputetët nëpër qytetet prej nga vijnë ata, duhet të jetë i shumëfishtë: t’i përgjigjet kërkesave të qytetarëve, t’i informojë qytetarët për aktivitetet e Kuvendit, t’i përfshijë grupet e interesit dhe qytetarët të ndikojnë në politikën publike, të marrin informatat e sakta mbi natyrën e problemeve në mënyrë që niveli i debatit në Kuvend të jetë më përmbajtësor dhe më frytdhënës.

Gjatë intervistave të realizuara me shefat e grupeve parlamentare, shumica prej tyre rëndësinë e zyrave për deputetë nuk e vejnë në dyshim si një nga format shumë të rëndësishme të komunikimit reciprok mes zgjedhësve dhe të zgjedhurve. Kryetari i grupit parlamentar të PDK-së Ramë Buja<sup>1</sup> vlerëson se hapja e këtyre zyrave ka rëndësi të madhe, pasi funksionalizon punën e deputetëve. Kuvendi është vonuar me faktin që nuk i ka krijuar deri më tani zyrat e tilla.

Nevojën e ekzistimit të zyrave të tilla e vlerëson edhe shefi i grupit parlamentar të LDK-së Ismet Beqiri duke thënë se ekziston një shkëputje e komunikimit të deputetëve me qytetarë<sup>2</sup>.

Mendim më ndryshe nuk kanë as deputetët që vijnë nga radhët e opozitës dhe nga ana e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë. Është e rëndësishme ekzistenca e këtyre zyrave, këtë e ka treguar edhe funksionimi gjashtë mujor i zyrave për deputetë përkrahur nga USAID, thotë deputeti Slobodan Petroviq<sup>3</sup> nga grupi parlamentar SLS. Po ashtu edhe shefi i grupit parlamentar të AKR-së që vjen nga blloku opozitar Ibrahim Makolli vlerëson se përpos punës në nxjerrjen e ligjeve, Kuvendi i Kosovës do të duhej që të ketë edhe komunikim të rregullt me qytetarët. Është dashur që në kuadër të Kuvendeve Komunale të hapen edhe zyrat e deputetëve. Deri

<sup>1</sup> Ramë Buja. Intervistë personale. 10 maj 2010. Prishtinë, Kosovë

<sup>2</sup> Ismet Beqiri. Intervistë personale. 11 maj 2010. Prishtinë, Kosovë

<sup>3</sup> Slobodan Petroviq. Intervistë personale. 10 prill 2010. Prishtinë, Kosovë

më tani ka pasur disa përpjekje, po që nuk janë realizuar shprehet ai<sup>4</sup>.

Nevojën e ekzistimit apo të vendosjes së një formë të komunikimit me qytetarët përkundër që e përkrahin të gjitha grupet parlamentare brenda Kuvendit të Kosovës, iniciativa për t'i lëvizur gjërat në këtë drejtim ka munguar nga ana e tyre. Përfundimisht bën iniciativa e vitit të kaluar nga ana e 7-8 deputetëve, që ishin pjesë e zyrës, e sponsoruar nga NDI (National Democratic Institute). Kërkesa e këtyre deputetëve ishte dërguar në Kryesinë e Kuvendit ku kishin marrë përgjigje se për këtë çështje Kryesia do të shikojë për mundësinë e bashkëpunimit me kuvendet komunale. Megjithatë deri më tani nuk ka pasur asnjë iniciativë nga Kryesia.

### 3. Iniciativat e gjertanishme për hapjen e zyrave për deputetë

Edhe pse jo në nivelin e duhur dhe të vazhdueshëm, megjithatë ka pasur iniciativa të ndryshme të deputetëve që të komunikojnë me qytetarët. Kryesisht këto iniciativa për hapjen e zyrave të deputetëve kanë individuale të deputetëve dhe të përkrahura nga organizatat të cilat mbështesin punën e Kuvendit të Kosovës, siç janë NDI dhe OSBE. Këto organizata kanë ndihmuar në themelimin e zyrës, trajnimin e stafit administrativ që ka punuar në këto zyre si dhe pajisjen e tyre. Ndër mangësitë kryesore që kanë pasur këto zyre kanë qenë mungesa e fondeve të mjaftueshme, hapësirave të duhura për ushtrim të funksionit dhe mbështetja institucionale. Të gjitha këto kanë bërë që këto zyre të mos funksionojnë në mënyrë të përhershme, të funksionojnë në objekte jo të përshtatshme për ushtrim të veprimtarisë dhe jo rrallë herë edhe të marrin ngjyrimë politike.

Funksionimi i këtyre zyrave është përballur me probleme të ndryshme të cilat në një mënyrë apo tjetër ka ndikuar edhe në efikasitetin e tyre. Iniciativa e parë e ndërmarrë nga ana e deputetëve ka qenë iniciativa e znj. Gjylnaze Sylja, e cila ka hapur një zyrë për deputetë në komunën e Pejës. Kjo zyrë për një periudhë rreth dy-vjeçare është përkrahur nga NDI. Kjo zyrë është hapur brenda objektit të degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë, dhe kjo mund të konsiderohet si një mangësi që ka pasur kjo zyrë. Hapja e zyrës në kuadër të degës së partisë, me apo qëllim, i ka dhënë një ngjyrosje politike kësaj zyre dhe ka ndikuar që jo të gjithë qytetarët të ndjehen komod për të vizituar këtë zyrë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për zyrën të cilën aktualisht e mban të hapur deputetja e LDK-së, znj. Myrveta Pantina, në komunën e Vushtrrisë. Kjo zyre funksionon në kuadër të objekteve komunale të komunës së Vushtrrisë, mirëpo për mungesë të fondeve në këtë zyrë punon bashkëshorti i znj. Pantina i cili njëkohësisht është edhe i punësuar në komunën e Vushtrrisë. Një gjë e tillë ndikon që kjo zyrë të mos jetë në çdo kohë e hapur, por

<sup>4</sup> Ibrahim Makolli, Intervistë personale. 08.maj 2010. Prishtinë, Kosovë

po ashtu edhe kësaj zyre mund t'i epet ngjyrim politik/familjar. Iniciativa tjera individualëve kanë qenë ajo e z. Fehmi Mujotës i cili pat hapur një zyre për deputetë në komunën e Shtimes, pastaj z. Hajredin Hyseni në Podujevë, Berat Luzha në Kaçanik, Xhavit Haliti në Pejë, si dhe grupi i deputetëve të Gjakovës (6 deputetë të legjislaturës së kaluar)<sup>5</sup>.

Gjatë vitit 2009, për një periudhë dy vjeqare, NDI ka hapur dy zyre për grup deputetësh, një në Prishtinë dhe një në Graçanicë. Në këto zyre, për takime me qytetarë kanë marrë pjesë nga një deputet për secilin grup parlamentar të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës. Për periudhën gjashtë mujore sa edhe ka funksionuar zyra për deputetë në Prishtinë, aty janë paraqitur 218 raste nga ana e qytetarëve. Kryesisht këto raste kanë pasur të bëjnë me strehim, punësim, privatizim (çështja e 20% të punëtorëve), konteste pronësore, arsim, shëndetësi, etj. Me mbarimin e përkrahjes financiare nga ana e NDI për këto dy zyre, edhe këto dy zyre kanë pushuar se funksionuari.

Një iniciativë tjetër e ndërmarrë kohëve të fundit dhe që dallon pak nga iniciativat që janë ndërmarrë deri më tani, është iniciativa e OJQ-së Syri i Vizionit. Kjo organizatë ka hapur një zyrë për komunikim me qytetarë e cila është e hapur çdo ditë pune nga ora 09:00-12:00. Një asistente që punon në këtë zyrë është përgjegjëse që t'i mbledh rastet që paraqiten nga qytetarët dhe pastaj varësisht nga rastet fton deputetët dhe qytetarët të cilët i kanë paraqitur ato raste që të komunikojnë me njëri tjetrin. Njoftimet për takimet qytetarë/deputetë bëhen përmes posterëve dhe thirrjeve telefonike. Takimet nuk mbahen vetëm në komunën e Pejës por mbahen edhe nëpër komuna tjera të rajonit të Pejës. Sa i përket interesimit të dyanshëm për të komunikuar me deputetë, përkatësisht qytetarë, sipas përfaqësuesve të Syrit të Vizionit nuk është edhe për t'u admiruar shumë, pasi që nga 22 deputetë sa ka rajoni i Pejës, vetëm 11 prej tyre janë të gatshëm për bashkëpunim<sup>6</sup>. Në anën tjetër edhe qytetarët nuk janë edhe shumë të interesuar që të vinë në këto takime dhe të shprehin shqetësimet e tyre para deputeteve. Për gati një vit sa implementohet ky projekt nga Syri i Vizionit, rreth 80 qytetarë kanë ardhur në takimet e organizuara. Paqartësia e kërkesave që kanë qytetarët për deputetët është një karakteristikë tjetër që kanë veçuar zyrtarët e Syrit të Vizionit.

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë, mund të konkludohet se deri më tani kanë ekzistuar disa iniciativa për të rritur komunikimin ndërmjet deputetëve dhe qytetarëve, mirëpo këto iniciativa kanë qenë më tepër iniciativa ad-hoc të cilat në shumicën e rasteve janë përkrahur nga organizata që mbështesin punën e Kuvendit të Kosovës, por nuk kanë qenë iniciativa që kanë rrjedhur ose mbështetur nga ana e Kuvendit të Kosovës; dhe që për arsye të ndryshme, e që më kryesorja është mos paraqitja e rregullt e deputetëve në këto zyra, edhe interesimi i qytetarëve për këto zyra nuk ka qenë edhe aq i madh.

<sup>5</sup> Arben Kelmendi (NDI). Intervistë personale. 10 maj 2010. Prishtinë, Kosovë

<sup>6</sup> Enver Ulaj. Intervistë personale. 11 prill 2010. Prishtinë, Kosovë



#### 4. Sistemi zgjedhor pengesë për avancim të komunikimit dy-kahor

Kosova në sistemin e saj zgjedhor përdor sistemin proporcional me lista të hapura, me një zonë të vetme zgjedhore. Sipas këtij sistemi, qytetarët e Kosovës mund të votojnë një parti politike apo një koalicion të caktuar me mundësi të rrumbullakimit të dhjetë emrave brenda të njëjtës parti. Zgjedhësi në këtë rast nuk zgjedh drejtpërdrejt përfaqësuesin e zonës ku ai banon dhe që do të mbronte interesat apo paraqes shqetësimet në lidhje me problemet e asaj zone, por ai zgjedh subjektin politik dhe nëse rastësisht ky qytetar jeton në një komunë më të vogël apo ku partitë politike janë më pak politikisht aktive atëherë komuna e tij mund që edhe të mbetet pa përfaqësues.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë, të mbajtura në nëntor 2007 vota e qytetarëve përmes sistemit aktual vendosi që të ketë komuna të cilat nuk do të jenë fare të përfaqësuara në Parlamentin e Kosovës. Rast konkret paraqet komuna e Kastriotit, komuna me probleme më të mëdha në aspektin ambiental dhe mjedisor.

Një sistem i tillë elektoral ku deputetët nuk e kanë një adresë të elektoratit të tyre por mund të marrin vota anekënd Kosovës, pengon një komunikim real dhe të sinqertë në mes të zgjedhësve dhe të zgjedhurve (elektorat-deputetë).

Një konstatim pothuajse të njëjtë kanë edhe disa nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe disa nga shefat e grupeve parlamentare, Problemi është tek mënyra e zgjedhjes së deputetit, pasi mos ndarja e vendit në zona, deputetët në fakt nuk janë të askujt, thotë Ismet Beqiri<sup>7</sup> shef i grupit parlamentar të LDK-së. Mendim të tillë ka edhe shefi i grupit parlamentar Ramë Buja<sup>8</sup> ku vlerëson se sistemi zgjedhor vazhdon të jetë problem për vendin, pasi nuk kemi shumë zona dhe përfaqësim më të madh të deputetëve.

Megjithatë mendim më ndryshe nuk kanë as deputetët që vijnë nga radhët e opozitës dhe nga ana e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

Sistemi zgjedhor proporcional me disa zona zgjedhore do të ishte më i favorshëm për Kosovën. Kjo nuk do të garantonte me çdo kusht edhe përfaqësim të çdo komune por do të garantojë një përfaqësim të barabartë dhe në përputhje me numrin e banorëve të çdo pjese të Kosovës. Deputeti në këtë rast nuk do të ketë obligime vetëm ndaj partisë por edhe ndaj zonës zgjedhore e cila e ka votuar duke e obliguar që të komunikojë me elektoratin dhe të transmetojë kërkesat e tyre. Këtu vetvetiu do të hyjë

<sup>7</sup> Ismet Beqiri, Intervistë personale, 5 maj 2010. Prishtinë Kosovë

<sup>8</sup> Ramë Buja. Intervistë personale. 10 maj 2010. Prishtinë, Kosovë

në funksion relacioni deputet – zonë zgjedhore, respektivisht obligimi i llogaridhënies ndaj zgjedhësve të tyre.

Sistemi elektoral me disa zona zgjedhore do të jetë më gjithëpërfshirës dhe do ta shndërronte Parlamentin vërtet në institucionin përfaqësues të qytetarëve të një vendi. Nëse një zonë zgjedhore varësisht nga numri i banorëve do të jepte një numër të caktuar të deputetëve, mundësia e përfaqësimit të spektrit politik në Kuvend është më e mundshme përfshirë edhe subjektet që përfaqësojnë komunitetet pakicë. Po ti referohemi zgjedhjeve të kaluara nëse kemi parasysh rezultatet në zona të caktuara kjo do të kishte mundësuar përfaqësimin në Kuvend të së paku një partie më shumë.

Për zgjedhjet nacionale që priten të mbahen në vitin e ardhshëm, institucionet kompetente të Kosovës duhet ta rishikojnë sistemin zgjedhor si një hap drejt mundësimin të përfaqësimit më të drejtpërdrejtë dhe më efikas të qytetarëve në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës të mos shërbejë vetëm si arenë partish politike por mbi të gjitha duke adresuar çështjet e qytetarëve të jetë zë i vet qytetarëve.

Aplikimi i sistemit zgjedhor i ndarë në zona zgjedhore, dëshmon faktin se deputeti do të ishte vërtet një interlokutorë që ka në dorë interesimin për zhvillimet që ndodhin brenda zonës të cilën ai e përfaqëson, për zgjidhjen e halleve dhe problemeve sociale nëpërmjet pozicionit të rëndësishëm politik, që e obligon atë që përveç detyrës prioritare si ligjvënës, të luajë rolin që nëpërmjet ndërmjetësimit të tij të ndikojë në strukturat e pushtetit qendror apo lokal.

Arsyen e ekzistimit të një Parlamenti, më tepër e justifikon fakti i përfaqësimit të interesave dhe halleve të qytetarëve se sa vetëm duke përfaqësuar partitë politike të një vendi.

## Si do të duhej të funksiononin zyrat për deputetë

Janë disa faktorë të cilët në një mënyrë apo tjetër do të ndikonin në përmirësimin e komunikimit ndërmjet deputetëve dhe qytetarëve. Kosova është një vend në tranzicion dhe me traditë jo shumë të madhe në demokraci, prandaj duhet kohë e konsiderueshme që të kemi një përmirësim të duhur të këtyre marrëdhënieve. Megjithatë, ndërmarrja e disa veprimeve konkrete nga ana e Kuvendit dhe aktorëve tjerë të përfshirë në këtë çështje pa dyshim që do të lehtësonin këtë proces.

Fillimisht Kuvendi i Kosovës do të duhej të krijonte një vijë të veçantë buxhetore për zyrat e deputetëve nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Kjo vijë buxhetore do të mbulonte shpenzimet për një asistent administrativ i cili do të ishte përgjegjës për mbajtjen e kontakteve të rregullta në mes të qytetarëve dhe deputetëve. Personeli që do të punonte në këto zyre do të duhej të zgjedhej me konkurs publik dhe do të duhej të ishte profesional. Ky personel do të duhej të kishte aftësi që të krijonte marrëdhënie të mira me qytetarët dhe mediat. Normalisht që këto zyre do të duhej të ishin të pajisura me kompjuterë dhe të kenë qasje në internet.

Kuvendi i Kosovës do të duhej që të nënshkruante një memorandum mirëkuptimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), me anë të cilit komunat e Kosovës do të ofronin pa pagesë, në mënyrë të përherëshme, një zyrë për deputetët e komunave të tyre respektive. Këto zyre duhet të jenë në një vend që janë të qasshme lehtë për qytetarët.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, do të duhej që së paku një ditë në javë të jenë të pranishëm në zyrat e deputetëve në komunat e tyre respektive. Në mënyrë që të krijohet një besim në mes të qytetarëve dhe deputetëve, këta të fundit duhet që ta respektojnë në maksimum orarin e përcaktuar. Normalisht që këtu duhet një harmonizim i Administratës së Kuvendit të Kosovës me asistentët e këtyre zyre. Praktikisht, deputetëve të Kuvendit të Kosovës nuk do të duhej që t'i caktohej mbledhje e komisioneve parlamentare në të cilat ata janë anëtarë në ditën kur ata e kanë të caktuar që të jenë në zyrat e deputetëve.

### **Komunikimi zgjedhës- të zgjedhur**

**Objektivi:** *Të mundësohet dhe konsolidohet komunikimi dy-kahor zgjedhës - të zgjedhur, me qëllim të rritjes së nivelit të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së publikut në jetën politike të vendit*

Aktiviteti i tërësishëm në këtë aspekt ka për qëllim përfundimtar krijimin dhe funksionalizimin e zyrave për deputetët e Kuvendit të Kosovës nëpër komunat prej nga vijnë ata në mënyrë që të fuqizohet roli përfaqësues i deputetit në komunikimin mes qytetarëve dhe institucioneve qendrore të shtetit.

## A. Masat

Hapja e zyrave për deputetë mund të realizohet përmes ndërmarrjes së këtyre masave:

***Masa 1: Hartimi i një plani të hollësishëm nga ana e Kuvendit të Kosovës për implementimin e kësaj iniciative***

### **Përshkrimi:**

**1.1.** Kuvendi i Kosovës duhet të hartoj një plan të hollësishëm për mënyrën e implementimit të kësaj iniciative që do të ishte i realizueshëm, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e gjithmbarshme politike dhe juridike në vend, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, duke synuar forcimin e nivelit të demokracisë dhe zhvillimin e institucionit më të lartë përfaqësues në vend – Kuvendit të Kosovës.

***Masa 2: Nënshkrimi i një memorandumi të mirëkuptimi mes Kuvendit të Kosovës dhe Komunave të Kosovës për sigurimin e hapësirave fizike nga ana e Kuvendeve Komunale***

### **Përshkrimi:**

**2.1.** Me qëllim që e tërë barra materiale (financiare) për implementimin e kësaj iniciative të mos i ngelet vetëm Kuvendit të Republikës së Kosovës, ky institucion duhet që ta nënshkruaj një memorandum mirëkuptimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës apo me secilën komunë veç e veç, ku sigurimi i hapësirave fizike (zyrave) tu ngelet obligim komunave të Kosovës. Ndërsa pjesa tjetër infrastrukturore dhe resurset humane të jenë obligim për Kuvendin e Kosovës.

***Masa 3: Të krijohet një linjë e veçantë buxhetore nga ana e Kuvendit të Kosovës në bashkëpunim me MEF-in (Ministria e Ekonomisë dhe e Financave), për të punësuarit dhe obligimet tjera financiare që dalin nga këto zyre***

### **Përshkrimi:**

**3.1.** Kuvendi i Kosovës në Bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës përkatësisht Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave duhet të krijojë një linjë të veçantë buxhetore për kryerjen e obligimeve financiare për krijimin dhe mbajtjen të funksionalizuar këtë zyre.

**Masa 4: Ndërtimin e një infrastrukturë funksionale për komunikim mes qytetarëve dhe deputetëve**

**Përshkrimi:**

4.1. Krijimi i zyrave për deputetë, pajisje me mjetet për punë (kompjuterë), punësimi i një nëpunësi i cili do ta koordinonte orarin e takimit të deputetëve me qytetarët e interesuar, janë të mjaftueshme për ndërtimin e një infrastrukturë funksionale për të realizuar qëllimin e këtyre zyrave.

**Masa 5: Ndryshimi i Ligjit Zgjedhor**

**Përshkrimi:**

5.1. Është i domosdoshëm ndryshimi i Ligjit aktual zgjedhor i cili Kosovën e shih si një zonë të vetme (unike) zgjedhore. Ndarja e Kosovës në disa zona zgjedhore do të ishte një hap drejt mundësimit të përfaqësimit më të drejtpërdrejtë dhe më efikas të qytetarëve në Kuvendin e Kosovës.

Aplikimi i një sistemi të tillë ku Kosova do të jetë e ndarë në zona zgjedhore, do ta mobilizonte deputetin që të interesohet në vazhdimësi për zhvillimet në zonën nga është deleguar, me qëllim të zgjidhjes së halleve sociale nëpërmjet rolit të tij të rëndësishëm si përfaqësues i popullit, nëpërmjet ndërmjetësimit të tij në hallkat e administratës së pushtetit qendror apo edhe atij lokal.



## PERSONNEL:

Ismet KRYEZIU - *Executive Director*  
Vjollca VOGËL - *Admin & Finance Manager*  
Leonora CIKAJ - *Admin & Finance Assistant*  
Arsim GJINOVCI - *IT & design*

## PROGRAM - CENTRAL GOVERNANCE:

Valmir ISMAILI - *Program Manager*  
Driton SELMANAJ - *Program Assistant*  
Isuf ZEJNA - *Monitor*  
Besnik RAMADANAJ - *Monitor*  
Liridon SELMANI - *Monitor*

## PROGRAM - LOCAL GOVERNANCE:

Naim CAHANAJ - *Coordinator*  
Ramadan KLISURICA - *Coordinator*

## PROGRAM - TRANSPARENCY AND ANTICORRUPTION

Merita MUSTAFA - *Program Manager*  
Esat MAZREKU - *Coordinator*

## Content

1.	Introduction.....	17
2.	The importance of two-way communication.....	18
3.	Initiatives so far for opening of constituency offices.....	19
	The electoral system, barrier for the two-way communication.....	21
	How should Constituency Offices Function?.....	23
	Communication of the Elected and the Electorate.....	23
A.	Measures.....	24
	Measure 1.....	24
	Measure 2.....	24
	Measure 3.....	24
	Description.....	24
	Measure 4.....	25
	Description.....	25
	Measure 5.....	25
	Description.....	25



## 1. Introduction

Besides its function as a law-making body and oversight of the executive branch, representation of citizens is another main function of the National Assembly. Specifically, the function of representation in the Assembly of Kosovo, respectively the two-way communication between the Members of the Parliament (MPs) and citizens, is the issues that will be treated in this discussion paper.

It is clear that up to now there has not been a close communication between the MPs and the electorate. In fact, there have been some ad hoc initiatives of different organizations that support the Assembly and of local NGOs, as well as some self-initiatives by MPs, but there was never an initiative by any institution that has been continued in this direction. Among the main reasons for the lack of communication between MPs and the electorate is considered to be the election system of Kosovo as well as the lack of necessary conditions in order to reach out to the citizens. However, the unwillingness of MPs to communicate with the electorate is another reason why currently there is not a healthy relationship between MPs and the electorate.

A series of round-tables organized by the Kosovo Democratic Institute (KDI) in different municipalities of Kosovo to discuss the work of MPs in the Third Legislature, has only confirmed the lack of two-way communication as well as the lack of communication between the local institutions and the MPs of Kosovo. However, in all of the roundtables, one of the general conclusions was that communication between MPs, citizens and mechanisms of the local government is more than necessary and that these relationships should be improved. On the other hand, the readiness of the stakeholders is expressed to do more to move in this direction.

Taking into account the conclusions of the roundtables mentioned above, KDI has taken this initiative to draft a discussion paper that will offer MPs of Kosovo an alternative as to how to improve their communication with the electorate.

---

**“In a democracy,  
the more people  
involved, the  
more results will  
be”**

**(Koch 1997)**

---

## 2. The importance of two-way communication

Constituency offices have a special importance in building communication relations between citizens and MPs so that citizens’ interests in their representative body are better portrayed. Through constituency offices, the representative role of an MP is achieved as he/she becomes a bridge between the citizens and central state institutions.

Constituency offices should aim to promote communication between MPs and the electorate in order to increase the level of representation and participation of citizens in the country’s political life, while strengthening the level of democracy and development of the Parliament as an institution, and also increasing the trust of citizens towards institutions, especially the legislative branch.

There are several purposes of having constituency offices throughout the cities where MPs are elected, such as respond to citizens’ requests, inform citizens about the activities of the Assembly, involve stakeholders and citizens to influence public policy, receive accurate information about the nature of problems so the level of debate in Assembly becomes more substantial and productive.

During the interviews with heads of parliamentary caucus, the majority of them do not question the importance of constituency offices as one of the more important forms of mutual communication between the voters and the elected. The head of parliamentary caucus of PDK, Ramë Buja<sup>1</sup> acknowledges that opening of such offices is of great importance as it functionalizes the work of MPs. The Assembly has delayed this problem already too long by the fact that it did not establish such offices up to now.

The necessity to have such offices was supported also by the head of parliamentary caucus of LDK, Ismet Beqiri, saying that there is a detachment of communication between MPs and citizens<sup>2</sup>.

MPs coming from the ranks of opposition and minority communities living in Kosovo share the same opinion. “It is important for such offices to be created, this is shown from the six-month operation of constituency offices supported by USAID” says MP Slobodan Petrovic<sup>3</sup> from the SLS parliamentary caucus. Also, the head of parliamentary caucus of AKR from the opposition bloc, Ibrahim Makolli stressed that besides working on legislation, the Assembly of Kosovo should have regular communication with citizens<sup>4</sup>. Constituency offices should have been planned under the Municipal Assemblies by now. There were several attempts but nothing concrete yet has been set.

---

<sup>1</sup> Rame Buja. Personal Interview. May 10, 2010. Prishtina, Kosovo

<sup>2</sup> Ismet Beqiri. Personal Interview. May 11, 2010. Prishtina, Kosovo

<sup>3</sup> Slobodan Petrovic. Personal Interview. April 10, 2010. Prishtina, Kosovo

<sup>4</sup> Ibrahim Makolli. Personal Interview. May 8, 2010. Prishtina, Kosovo

The necessity of establishing and having an institutionalized way to communicate with citizens, despite the support given to the idea by all of the parliamentary caucuses in the Assembly, lacks the initiative to move things in this direction. An exception is the initiative of last year by 7-8 MPs who were part of Constituency offices sponsored by NDI (National Democratic Institute). Their request was sent to the Presidency of Assembly from where they got the answer that Presidency will explore the possibility of cooperation with Municipal Assemblies on such issue. However so far there has been no initiative by the Presidency.

### 3. Initiatives so far for opening of constituency offices

Although not in a high level or continues, there were various initiatives by MPs to communicate with citizens. Mostly these initiatives for constituency offices were individual initiatives of MPs and assisted by organizations that support the Assembly, such as NDI and OSCE. These organizations have helped in establishment of the office, training of the administrative staff that works in these offices and provide their equipment. Among the main draw-backs for these offices has been the lack of sufficient funding, adequate space to operate and institutional support. All of the above, are reasons have made such offices to be temporary, not functioning in appropriate places and often labeled with political colors.

The functioning of such offices has faced various problems which in one way or another have influenced their effectiveness. The first initiative by MPs was taken by Mrs Gjylnaze Sylja, who opened a constituency office in the municipality of Peja. This office for a two-year period was supported by NDI. This office was opened in the building of the Alliance for the Future of Kosovo (AAK) branch in Peja, and this can be regarded as a draw back that this office had. Opening the office within the party, with or without any purpose, has given a political color to the office and had an affect why not all citizens felt comfortable to visit this office. The same can be said about the office which currently holds the MP from LDK, Mrs Myrvete Pantina in the municipality of Vushtrria. This office operates in the municipal building of the Municipality of Vushtrria, but due to the lack of funds, the husband of Mrs Pantina is working in this office, who is also employed in municipality of Vushtrria. This is the reason the office is not open at all times and also can be given a family and political bias. Other individual initiatives were from Mr.Fehmi Mujota who opened an office in municipality of Shtime, then Mr Hajredin Hyseni in Podujevo, Berat Luzha in Kacanik, Xhavit Haliti in Peja and also the group of MPs from Gjakova (6 MPs of the previous legislature)<sup>5</sup> .

During 2009, in a two-year period, NDI had opened two offices for a group of MPs, in Prishtina and in Gracanica. In these offices, meetings

---

<sup>5</sup> Arben Kelmendi (NDI). Personal Interview. May 10, 2010. Prishtina, Kosovo

with citizens were attended by one representative of each parliamentary caucus represented in Assembly of Kosovo. For a six month period that the Constituency office in Prishtina operated, there were 218 cases filed by citizens. Mostly these cases had to do with housing, employment, privatization (20% compensation for former employees of privatized corporations), property disputes, education, health etc. When the financial support from NDI ended for these offices, they also ceased functioning.

A new initiative undertaken recently which differs from other initiatives so far is the initiative by NGO Eye of Vision. This organization has opened an office to communicate with citizens, which is open each working day from 09:00 to 12:00 am. An assistant who works in the office is responsible for collecting cases submitted by citizens and, then, depending on the case, the assistant facilitates a meeting between the MPs and the citizens who submitted the case to discuss the issue. Announcements for the meeting citizen/MP are made through posters and telephone calls. Meetings are not held only in the municipality of Peja but also in other municipalities of Peja region. The mutual interest to communicate, according to the representatives of Eye of Vision is not to be admired fully, because of the 22 MPs from region of Peja only 11 are willing to cooperate in such an initiative<sup>6</sup>. On the other hand, the citizens are not very interested in coming to these meetings to express their concerns before MPs. For nearly a year since the project started by Eye of Vision, about 80 citizens have take part in the meetings. The lack of clarity and the requests that citizens have for MPs is another characteristic which the representatives of Eye of Vision have stressed.

Of all that is said above, it can be concluded that so far there have been several initiatives to increase communication between MPs and the citizens, but these initiatives have been more ad-hoc initiatives which in most cases were initiated by organizations which support the work of Kosovo Assembly, and were not taken or supported from the Kosovo Assembly; and for various reasons, mostly the casual, not-regular participation of MPs in the offices, the interest of citizens for these offices has not been all that great.

---

<sup>6</sup> Enver Ulaj. Personal Interview. April 11, 2010. Prishtina, Kosovo

#### 4. The electoral system, barrier for the two-way communication

Kosovo in its electoral system uses the proportional election system with open lists, with a single election zone. Based on this system, the citizens of Kosovo can vote a political party or a coalition by circling ten names within the same party. The citizen in this case does not directly elect the representative of area where he/she lives and the one who would protect the interests or represent the concerns related to that area, but he/she chooses a political entity. If by chance this citizen lives in a small municipality or in some place where political parties are less active, than his municipality can be left out without any representative.

On the last parliamentary elections in Kosovo, held on November 2007, the vote of citizens through the current system decided that there will be municipalities which will not be represented even with a single seat in the Parliament of Kosovo. A particular case is the municipality of Kastriot, the most damaged municipality in the environmental aspect.

Such electoral system where MPs do not have an address to their constituents but can receive votes throughout Kosovo, prevents a true and honest communication between the electorate and the elected (the electorate – MPs).

Members of Parliament of Kosovo and heads of parliamentary caucuses assess the problem in a very similar way. Ismet Beqiri<sup>7</sup>, the head of parliamentary caucus of LDK stressed that “the method by which MPs are elected, in a one-election zone, does not make them accountable to anybody.” The same is opinion shared by the head of parliamentary caucus, Ramë Buja who states that “a problem that continues to follow the country related to this issue is the electoral system, since we do not have more zones and greater representation of MPs<sup>8</sup>.”

However, MPs coming from the opposition ranks and minority communities living in Kosovo do not hold much different opinions.

The proportional electoral system with some more election zones would be more favorable for Kosovo. This would not guarantee by any means the representation of each municipality but it would guarantee equal representation in accordance with the number of inhabitants of any part of Kosovo. The MP in this case would not have obligations only to the party but also to the electoral zone which has voted him/her and this would obligate him/her to communicate and broadcast the election zone’s demands. In this way, the relationship between the MP and election zone

---

<sup>7</sup> Ismet Beqiri. Personal Interview. May 11, 2010. Prishtina, Kosovo

<sup>8</sup> Rame Buja. Personal Interview. May 10, 2010. Prishtina, Kosovo

would automatically start function, respectively obliging more accountability to their electorate in the Assembly

The electoral system with more electing zones would be comprehensive and would transform the Parliament as an institution into a truly representative of the citizens of this country. If an electoral zone, depending on its number of inhabitants, would give certain number of MPs, the possibility of political spectrum representation in the Assembly is more likely, including subjects representing minority communities. If we refer to past elections considering the results in certain areas, this system would have allowed at least one more political party to be represented in the legislature.

For national elections, expected to be held next year, competent Kosovo institutions should review the electoral system as a step toward in order to enable more direct and effective representation of citizens in Kosovo Assembly. The Assembly of Kosovo should not be only an arena of political parties but above all, while addressing the issues of citizens, it would be the voice of the citizens.

Application of the electoral system of many election districts, would demonstrate that MP would become catalysts for the zonal development, to solve social problems through the important political role, which obligates the MP to play the role of influence in the central and local government.

The reason for having a National Assembly is justified more by the need to represent the interests and concerns of citizens rather than just representing political parties of a country.

## How should Constituency Offices Function?

There are a few factors that in one way or another will affect the improvement of communication between MPs and the electorate. Kosovo is a country in transition without a long tradition in democracy; therefore it needs to have considerable time in order to have the desirable situation in these relationships. Nonetheless, undertaking concrete actions by the Assembly of Kosovo and other involved actors in this issue undoubtedly will ease this process.

Initially, the Assembly of Kosovo should create a separate budget line for constituency offices for all of the municipalities of Kosovo. The budget line should cover expenses for one administrative assistant, which would be responsible for keeping regular contacts between MPs and the citizens. The staff that would be employed in these offices should be chosen by public job postings and it should be professional. The staff must have the skills to create good relations with the citizens and the media. Naturally, these offices should be equipped with computers and have access to Internet.

The Assembly of Kosovo should sign a Memorandum of Understanding with the Association of Kosovo Municipalities (AKK), through whom the municipalities would offer one office for MPs, without a fee and in a permanent basis. The offices should be in a place that is easily accessible to the citizens.

Members of the Assembly of Kosovo should be present at least one day a week in the Constituency Office of their respective municipality. In order to create a trust between citizens and MPs, the latter should respect the schedule that they set for their attendance in these offices. Naturally, here is the need for coordination of the administration of the Assembly of Kosovo with the assistants of constituency offices. Practically, MPs should not leave their parliamentary committee meetings on the day that they are set to be meeting with citizens in the Constituency Office.

### Communication of the Elected and the Electorate

**Objective:** *To enable and consolidated the two-way communication, the elected-the electorate, with the aim of increasing the level of representation and participation of the public in the political life of the country*

The whole activity in this aspect has its final aim the creation and function of Constituency Offices for MPs throughout the municipalities where they originate as to strengthen the representative role of the MP in communicating with the citizens and the central institutions of Kosovo.

## A. Measures

Initiation of Constituency Offices can be accomplished by undertaking these measures:

### ***Measure 1: Drafting a thorough plan by the Assembly of Kosovo to implement this initiative***

#### **Description:**

**1.1.** The Assembly of Kosovo should draft a thorough plan to detail the implementation of this initiative, which would be feasible, with the aim of increasing citizen participation in the comprehensive political and legal processes of the country, through their elected representatives, at the same time, aiming to strengthen the level of democracy and institutional development of the highest representative institution of the land – the Assembly of Kosovo.

### ***Measure 2: Signing a Memorandum of Understanding between the Assembly of Kosovo and the Association of Kosovo Municipalities***

#### **Description:**

**2.1.** Intending not to place the whole burden (financial) of implementing this initiative only on the Assembly of the Republic of Kosovo, this institution should sign a Memorandum of Understanding with the Association of Kosovo Municipalities or with each municipalities individually, which would specify that securing of physical space (offices) would be the responsibility of the municipalities of Kosovo.

### ***Measure 3: To create a separate budget line by the Assembly of Kosovo in cooperation with the Ministry of Economy and Finance (MEF) for the staff and other financial obligations as a result of Constituency Offices***

#### **Description:**

**3.1.** The Assembly of Kosovo in cooperation with the Government of Kosovo, respectively the Ministry of Economy and Finance should create a separate budget line to cover financial obligations for the creation and maintenance of these offices.

### ***Measure 4: Installing a functional infrastructure for communication between the citizens and MPs***

#### **Description:**

**4.1.** Creation of Constituency Offices equipped with working tools (com-



puters), employment of one staff, which would coordinate the schedule of MPs with the interested citizens, are necessary for building of a functional infrastructure to accomplish the goal of such offices.

### **Measure 5: Changing the Law on Elections**

#### **Description:**

**5.1.** It is necessary the changing of the current election law, which sets up Kosovo as one (unique) election zone. Division of Kosovo into many election zones would be a step towards the enablement of direct and more effective representation of citizens in the Assembly of Kosovo.

Application of such a system where Kosovo would have many election zones, would mobilize the MP to be more interested constantly for the development of the zone which delegates him/her, and would stimulate the MP to solve the social problems through the important role as a representative of the people, through his/her facilitation in linking the administration of the central government and of the local government.







**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA



INSTITUTE FOR  
**Sustainable  
Communities**



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*



**ROYAL NORWEGIAN EMBASSY**